



**Prishtinë, 01 mars 2013**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_504\_2013**

## **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

### **Duke u bazuar në:**

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin “WindPark - Zatriç, komuna e Rahovecit, me kapacitet të instaluar prej 30 MW, të datës 30.10.2012 të ndërmarrjes “UPWIND International I GmbH – Dega në Kosovë”, me adresë: rruga “Nëna Terezë, Hyrja IV, kati II, Prishtinë, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur me datë 01 mars 2013 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

### **Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar**

- I.** Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “UPWIND International I GmbH – Dega në Kosovë”, ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era, në lokacionin “WindPark - Zatriç, me kapacitet të instaluar prej 30 MW, komuna e Rahovecit.
- II.** Aplikantit “UPWIND International I GmbH –Dega në Kosovë”, mund t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenin 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III.** Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV.** Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar, i lëshohet ndërmarrjes “UPWIND International I GmbH –Dega në Kosovë”, për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të bëjë kërkesë me shkrim duke kërkuar që ti lëshohet Autorizimi për ndërtim të stabilimenteve të reja gjenerues nga Era.



## Arsyetim

- ZRRE me datë 30.10.2012 nga ndërmarrja “UPWIND International I GmbH –Dega në Kosovë”, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, në lokacionin “WindPark - Zatriç, me kapacitet të instaluar prej 30 MW, komuna e Rahovecit.
  - ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

### Bordi i ZRRE-së:

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar.